

16 janar 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe sipas kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore të datës 12.01.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së ("KD"), me datë 16.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. KONSTATOHET Kërkesa për Inicim të Procedurës Disiplinore e datës 12.01.2026 si e BAZUAR;
- II. SHQIPTOHET masa disiplinore "Ndalësë kryerje të detyrës për periudhë prej gjashtë (6) muaj" ndaj gjyqtarit Dren Pudarolli, për shkelje disiplinore sipas Nenit 53(1)(a);
- III. Masa sipas pikës III të këtij vendimi do të ketë efekt ndalësë për kryerje të detyrës në të gjitha ndeshjet dhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të garave të organizuara nga FBK;
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 12.01.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së ("KD"), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore të datës 12.01.2026 (tash e tutje "Kërkesa"), e cila ka të bëjë me supozimin për sjellje të papërshtatshme dhe jo-profesionale të gjyqtarit Dren Pudarolli, në ndeshjen e zhvilluar me datë 11 janar 2026, me fillim nga ora 17:00, në Palestrën Sportive "Minatori" në Mitrovicë, ndërmjet KB Trepça dhe KB Sigal Prishtina.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, KD, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 13.01.2026, në orën 17:10, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç' rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, KD, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet administratës së FBK-së, t'i kërkohej deklaratë me shkrim palës ndaj të cilit është iniciuar procedura.

Më datën 14.01.2026, KD, nëpërmjet email-it, sipas kërkesës, ka pranuar deklaratën me shkrim nga z. Dren Pudarolli.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 13.01.2026, KD ka komunikuar edhe me datë 15.01.2026, ku ka shqyrtuar deklaratën me shkrim nga z. Pudarolli dhe provat e tjera të administruara nga sekretaria, përfshirë raportin e Policisë së Kosovës – Sektori i Operativës, fotografitë dhe video-incizimet. Gjatë shqyrtimit, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, bazën ligjore, si dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

KD potencon se dispozita përkatëse që trajton këtë rast është Neni 53, alinea 1, pika a) i Rregullores Disiplinore i cili thotë:

1. Shkelje veçanërisht në lidhje me delegatin apo gjyqtarin konsiderohen këto si në vijim:
 - a) Delegati dhe gjyqtari të cilët me papërgjegjësi, pakujdesi, dhe angazhim të pamjaftueshëm e kryejnë detyrën.

Në rastin konkret, KD ka konstatuar, bazuar në video-incizimet e ndeshjes, se gjatë zhvillimit të ndeshjes së datës 11.01.2026, gjyqtari në fjalë ka bërë një gjest me dorë, i cili është i dukshëm dhe i identifikueshëm në pamjet filmike dhe që, nga publiku dhe aktorë të pranishëm në ndeshje, është perceptuar si gjest fyes dhe i papërshtatshëm për një zyrtar të ndeshjes, gjë që mbështetet edhe nga reagimet e shikuesve të evidentuara në të njëjtat video-incizime.

Edhe pse z. Pudarolli në deklaratën e tij ka sqaruar se veprimi ka qenë i pavetëdijshëm, pa qëllim fyes dhe si shprehje personale për përqendrim, Komisioni vlerëson se përgjegjësi disiplinore e gjyqtarit nuk vlerësohet vetëm sipas qëllimit subjektiv, por edhe sipas perceptimit objektiv të sjelljes së tij në publik dhe ndikimit që ajo ka në mjedisin dhe rrjedhën e garës. Gjyqtarët janë të obliguar të ruajnë jo vetëm paanshmërinë, por edhe pamjen e jashtme të autoritetit, seriozitetit dhe profesionalizmit, dhe çdo sjellje që mund të interpretohet si provokuese, nënçmuese ose jo serioze e cenon këtë standard.

Për më tepër, nga provat e dosjes dhe nga raporti i Policisë së Kosovës rezulton se gjatë kësaj ndeshjeje ka pasur tensione dhe sjellje të papërshtatshme të shikuesve. Sipas Nenit 41 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, gjyqtarët kanë obligim që të marrin masa për

ruajtjen e rendit dhe disiplinës në sallë. Mosveprimi i duhur i gjyqtarit në këtë kontekst përbën neglizhencë profesionale.

Në këtë mënyrë, edhe në mungesë të provës për një qëllim fyes të drejtpërdrejtë, veprimi dhe mosveprimi i gjyqtarit Pudarolli përbëjnë kryerje të detyrës me pakujdesi, papërgjegjësi dhe angazhim të pamjaftueshëm, në kuptim të Nenit 53(1)(a) të Rregullores Disiplinore të FBK-së.


Komisioni po ashtu vlerëson se rasti në fjalë nuk ka elemente të korrupsionit, manipulimit të ndeshjes, konfliktit të interesit, dhunës, kërcënimit apo përfitimit personal, prandaj kjo shkelje nuk përbën cenim të integritetit të garës, por mbetet në sferën e sjelljes së pahijshme dhe neglizhencës profesionale.

Nga dosja e lëndës po ashtu nuk rezulton se kjo sjellje ka shkaktuar dëm sportiv, financiar apo ka ndikuar në rezultatin e ndeshjes apo integritetin e garës. Megjithatë, Komisioni vlerëson se është shkaktuar dëm institucional, për shkak të cenimit të autoritetit të gjyqtarëve dhe imazhit të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe sportit të basketbollit në përgjithësi.

Komisioni ka marrë parasysh deklaratën e gjyqtarit, mungesën e qëllimit fyes dhe shprehjen e keqardhjes në rast se dikush është ndjerë i fyer, si dhe faktin se z. Dren Pudarolli ka mbi 20 vite përvojë profesionale dhe nuk rezulton të ketë qenë më parë i ndëshkuar për shkelje të ngjashme, të cilat në tërësi përbëjnë rrethana lehtësuese.

Duke marrë parasysh natyrën e shkeljes, sjelljen e papërshtatshme dhe neglizhencën profesionale të gjyqtarit, perceptimin e këtij veprimi nga publiku dhe ndikimin në mjedisin e garës, si dhe cenimin e imazhit institucional të FBK-së dhe të sportit të basketbollit në përgjithësi, Komisioni vlerëson se bëhet fjalë për një shkelje të izoluar që tejkalon kufijtë e shkeljeve të lehta trajtuar me vërejtje ose ndalesë për 1-3 ndeshje (neni 54(1)(a) dhe (b)), por nuk ka shkaktuar dëm serioz sportiv ose cenim të integritetit të garës. Për këtë arsye, masa e përshtatshme dhe proporcionale është ndalesa e kryerjes së detyrës për periudhë prej gjashtë (6) muajsh sipas Nenit 54(1)(c), e cila hyn në fuqi me nënshkrimin e këtij vendimi dhe ka efekt ndalues për kryerjen e detyrës në të gjitha ndeshjet dhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të garave të organizuara nga FBK, duke u zbatuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi

Anëtar



Omer Daku

Kryetar



Blerim Vuniqi

Anëtar

Prishtinë, 16 janar 2026

Vendimi i dërgohet:

- Dren Pudarolli
- Shoqatës së Gjiqtarëve të Basketbollit të Kosovës
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Anëtarëve të Komisionit për Nominimin e Personave Zyrtarë të Ndeshjeve
- Arkivit të FBK-së

***Këshilla Juridike:***

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.